Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 14
Llogaritë e Shtyra për Arsye Rregullatore

Objektivi

1 Objektivi i këtij Standardi qëndron në përcaktimin e kërkesave për raportimin financiar të *tepricave të llogarive të shtyra për arsye rregullatore* që ndeshen në rastin e njësive ekonomike që ofrojnë tek klientët mallra ose shërbime të cilat janë subjekt i *rregullimit të normës (tarifës)*.

2 Për plotësimin e këtij objektivi, Standardi kërkon:

(a) ndryshime të kufizuara në politikat kontabël të zbatuara në përputhje me parimet kontabël përgjithësisht të pranuara të mëparshme (*PPPK të mëparshme*) për tepricat e llogarive të shtyra për qëllime rregullatore, të cilat lidhen kryesisht me paraqitjen e këtyre llogarive; dhe

(b) dhënie informacionesh shpjeguese që:

(i) identifikojnë dhe shpjegojnë shumat e njohura në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike lidhur me rregullimin e normës (tarifës); dhe

(ii) ndihmojnë përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë shumën, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme monetare nga çdo tepricë në llogaritë e shtyra për arsye rregullatore të njohur.

3 Kërkesat e këtij Standardi lejojnë që njësitë ekonomike brenda objektit të tij kur zbatojnë SNRF-të, të vijojnë trajtimin e tepricave për llogaritë e shtyra për arsye rregullatore në pasqyrat financiare të tyre në përputhje me PPPK-të e mëparshme, duke respektuar kufizimin e ndryshimeve të cilësuar në paragrafin 2 mësipërme.

4 Gjithashtu Standardi paraqet dhe disa përjashtime për ose nga kërkesat e Standardeve të tjera. Të gjitha kërkesat specifike për raportimin e tepricave të llogarive të shtyra dhe çdo përjashtim për ose nga kërkesat e Standardeve të tjera lidhur me këto teprica përfshihen në këtë Standard dhe jo në Standardet e tjera.

Objekti

5 Një njësi ekonomike lejohet të zbatojë kërkesat e këtij Standardi në *pasqyrat e saj financiare të para sipas SNRF-ve* nëse dhe vetëm nëse:

(a) realizon *aktivitete me normë (tarifë) të rregullueshme*; dhe

(b) njeh shumat që plotësojnë përkufizimin e tepricave të shtyra për arsye rregullatore në pasqyrat e saj financiare në përputhje me PPPK-të e mëparshme.

6 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë kërkesat e këtij Standardi në pasqyrat e saj financiare për periudhat e mëpasshme, nëse dhe vetëm nëse, në pasqyrat e saj të para sipas SNRF-ve, ka zgjedhur të zbatojë kërkesat e këtij Standardi për njohjen e tepricave të llogarive të shtyra për arsye rregullatore.

7 Ky Standard nuk trajton aspektet e tjera të kontabilitetit të njësive ekonomike të angazhuara në aktivitete me normë (tarifë) të rregullueshme. Nëse janë të zbatueshme kërkesat e këtij Standardi , çdo shume që lejohet ose kërkohet të njihet si aktiv ose detyrim në përputhje me Standardet e tjera, nuk duhet të përfshihet në shumat e klasifikuara si teprica të llogarive të shtyra për arsye rregullatore.

8 Një njësi ekonomike që është brenda objektit të këtij Standardi dhe zgjedh ta zbatojë atë, duhet të zbatojë të gjitha kërkesat e Standardit për të gjitha tepricat e llogarive të shtyra për arsye rregulatore që vijnë nga aktivitete me normë (tarifë) të rregullueshme.

Njohja, matja, zhvlerësimi dhe çregjistrimi

Përjashtime të përkohshme nga paragrafi 11 i SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*

9 **Nëse një njësi ekonomike që realizon aktivitete me normë (tarifë) të rregullueshme, është brenda objektit të këtij Standardi dhe zgjedh ta zbatojë atë, duhet të zbatojë paragrafët 10 dhe 12 të SNK 8 kur përpilon politikat e saj kontabël për njohjen, matjen, zhvlerësimin dhe çregjistrimin e tepricave të llogarive të shtyra për arsye rregullatore.**

10 Paragrafët 11–12 të SNK 8 specifikojnë burimet e kërkesave dhe udhëzimeve që drejtimit i kërkohet ose i lejohet të marrë në konsideratë gjatë përpilimit të një politike kontabël për një zë, nëse asnjë SNRF nuk gjen zbatim specifik për atë zë. Ky Standard e përjashton një njësi ekonomike nga zbatimi i paragrafit 11 të SNK 8 për politikat e saj kontabël për njohjen, matjen, zhvlerësimin dhe çregjistrimin e tepricave të llogarive të shtyra për arsye rregullatore. Për pasojë, njësitë ekonomike që njohin tepricat e llogarive të shtyra për arsye rregullatore si zëra individualë ose si pjesë e vlerës kontabël neto të aktiveve ose detyrimeve të tjera në përputhje me PPPK-të e mëparshme të tyre, lejohen të vijojnë njohjen e këtyre tepricave në përputhje me këtë Standard sipas përjashtimit në paragrafin 11 të SNK 8 me kushtin e ndryshimeve në paraqitje të kërkuara nga paragrafët 18–19 të këtij Standardi.

Vijimësia e politikave kontabël ekzistuese

11 **Gjatë zbatimit për herë të parë të këtij Standardi, një njësi ekonomike duhet të vijojë zbatimin e politikave kontabël sipas PPPK-ve të mëparshme të saj për njohjen, matjen, zhvlerësimin dhe çregjistrimin e tepricave të llogarive të shtyra për arsye rregullatore me përjashtim të ndryshimeve të kërkuara nga paragrafët 13–15. Megjithatë, paraqitja e shumave të tilla duhet të plotësojë kërkesat për paraqitje të këtij Standardi , të cilat mund të kërkojnë ndryshime nga politikat e PPPK-ve të mëparshme të njësisë ekonomike për paraqitjen (shih paragrafët 18–19).**

12 Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë politikat e përcaktuara në përputhje me paragrafin 11, në të njëjtën mënyrë edhe në periudhat vijuese me përjashtim të ndryshimeve të lejuara nga paragrafët 13–15.

Ndryshimet në politikat kontabël

13 **Njësia ekonomike nuk duhet t'i ndryshojë politikat e saj kontabël me qëllim njohjen për herë të parë të tepricave të llogarive të shtyra për arsye rregullatore. Një njësi ekonomike mund t'i ndryshojë politikat e veta kontabël për njohjen, matjen, zhvlerësimin dhe çregjistrimin e tepricave të llogarive të shtyra për arsye rregullatore vetëm nëse ky ndryshim i bën pasqyrat financiare më përkatëse për nevojat e përdoruesve në marrjen e vendimeve ekonomike dhe jo më pak të besueshme[1] , ose më të besueshme dhe jo më pak përkatëse për këto nevoja. Njësia ekonomike gjykon mbi përkatësinë dhe besueshmërinë sipas kriterit të paragrafit 10 të SNK 8.**

14 Ky Standard nuk i përjashton njësitë ekonomike nga zbatimi i paragrafëve 10 ose 14–15 të SNK 8 për ndryshimet në politikat kontabël. Për të justifikuar ndryshimin e politikave të saj kontabël për tepricat e llogarive të shtyra për arsye rregullatore, një njësi ekonomike duhet të tregojë se si pasojë e ndryshimit pasqyrat financiare do t'i plotësojnë më mirë kërkesat në paragrafin 10 të SNK 8. Megjithatë nuk nevojitet që ndryshimi të sigurojë një pajtim të plotë me këto kritere për njohjen, matjen, zhvlerësimin dhe çregjistrimin e tepricave të llogarive të shtyra për arsye rregullatore.

15 Paragrafët 13–14 zbatohen si për ndryshimet e bëra gjatë zbatimit për herë të parë të këtij Standardi ashtu dhe për ndryshimet e bëra gjatë periudhave pasuese të raportimit.

Ndërveprimi me Standardet e tjera

16 **Çdo përjashtim specifik, kërkesa për përjashtim ose kërkesa shtesë mbi lidhjen e këtij Standardi me Standarde tjera paraqiten në këtë Standard (shih paragrafët B7–B28). Në mungesë të një përjashtimi**

---

1 Në Shtator 2010, BSNK zëvendësoi *Kuadrin për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare* me *Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar*. Termi "paraqitje besnike" përfshin karakteristikat kryesore të termit që në *Kuadrin* e vjetër thirrej "besueshmëria". Kërkesa në paragrafin 13 të këtij Standardi mbështetet në kërkesat e SNK 8, që ruan termin "i besueshëm".

© IFRS Foundation

të tillë, kërkese për përjashtim ose kërkese shtesë, Standardet e tjera duhet të zbatohen për tepricat e llogarive të shtyra për arsye rregullatore në të njëjtën mënyrë si për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e njohura në përputhje me Standardet e tjera.

17 Në disa raste, mund të jetë e nevojshme që për të pasqyruar në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike tepricën e një llogarie të shtyrë për arsye rregullatore të matur në përputhje me politikat kontabël të përcaktuara sipas paragrafëve 11–12, të zbatohet një Standard tjetër. Për shembull, njësia ekonomike mund të ketë aktivitete me normë (tarifë) të rregullueshme në një vend të huaj ku transaksionet dhe tepricat e llogarive të shtyra për arsye rregullatore shprehen në një monedhë që nuk është monedha funksionale e njësisë ekonomike raportuese. Tepricat e llogarive të shtyra për arsye rregullatore dhe ndryshimet në këto teprica konvertohen sipas SNK 21 *Efektet e Ndryshimit në Kurset e Këmbimit*.

Paraqitja

Ndryshimi në paraqitje

18 Në paragrafët 20–26, ky Standard prezanton kërkesat për paraqitje për tepricat e llogarive të shtyra për arsye rregullatore të njohura në përputhje me paragrafët 11–12. Kur zbatohet ky Standard, tepricat e llogarive të shtyra për qëllime rregullatore njihen në pasqyrën e pozicionit financiar, veçmas aktiveve dhe detyrimeve të njohura në përputhje me Standardet e tjera. Këto kërkesa për paraqitje mundësojnë izolimin e ndikimit të kërkesave për raportim financiar të Standardeve të tjera, në njohjen e tepricave të llogarive të shtyra për qëllime rregullatore.

19 Përvec zërave që kërkohen të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrën (pasqyrat) e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera përmbledhëse në përputhje me SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*, një njësi ekonomike që zbaton këtë Standard duhet të paraqesë edhe të gjitha tepricat e llogarive të shtyra për qëllime rregullatore dhe lëvizjet në këto teprica në përputhje me paragrafët 20–26.

Klasifikimi i tepricave të llogarive të shtyra për arsye rregullatore

20 Një njësi ekonomike duhet të paraqesë si zëra të veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar:

(a) totalin e të gjitha tepricave debitore të llogarive të shtyra për qëllime rregullatore; dhe

(b) totalin e të gjitha tepricave kreditore të llogarive të shtyra për qëllime rregullatore.

21 Kur një njësi ekonomike paraqet aktive afatshkurtra dhe afatgjata dhe detyrime afatshkurtra dhe afatgjata, si klasifikime individuale në pasqyrën e saj të pozicionit financiar, ajo nuk duhet t'i klasifikojë totalet e tepricave të llogarive të shtyra për arsye rregullatore si afatshkurtra ose afatgjata. Por zërat e veçantë të kërkuar në paragrafin 20 duhet të dallohen nga aktivet dhe detyrimet e paraqitura në përputhje me Standardet e tjera, nëpërmjet përdorimit të nën-totaleve të nxjerra para paraqitjes së tepricave të llogarive të shtyra për arsye rregullatore.

Klasifikimi i lëvizjeve në tepricat e llogarive të shtyra për arsye rregullatore

22 Një njësi ekonomike duhet të paraqesë në seksionin e të ardhurave të tjera përmbledhëse të pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera përmbledhëse, lëvizjen neto për periudhën e raportimit të të gjitha tepricave të llogarive të shtyra për arsye rregullatore që lidhen me zërat e njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse. Zëra të veçantë duhet të përdoren për paraqitjen e lëvizjes neto të lidhur me zërat që në përputhje me Standardet e tjera:

(a) nuk do të riklasifikohen më pas në rezultat; dhe

(b) do të riklasifikohen më pas në rezultat nëse plotësohen kushte të caktuara.

23 Njësia ekonomike duhet të paraqesë në seksionin e fitimit ose humbjes të pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, ose në pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes, një zë të veçantë për pjesën e mbetur të lëvizjes neto të të gjitha tepricave të llogarive të shtyra për arsye rregullatore për periudhën raportuese, me përjashtim të lëvizjeve që nuk pasqyrohen në fitim ose humbje, si psh shumat që vijnë nga blerja. Ky zë i veçantë duhet të dallohet nga të ardhurat dhe shpenzimet e paraqitura në përputhje me Standardet e tjera nëpërmjet përdorimit të nën totaleve të nxjerra para lëvizjes neto të tepricave të llogarive të shtyra për arsye rregullatore.

24 Njësia ekonomike që njeh një aktiv tatimi të shtyrë ose një detyrim tatimi të shtyrë si pasojë e njohjes së tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, duhet të paraqesë aktivin (detyrimin) për tatime të shtyra që rezulton dhe lëvizjen përkatëse të tij bashkë me tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore dhe lëvizjet në këto teprica dhe jo të përfshirë në totalin e paraqitur në përputhje me SNK 12 *Tatimet mbi te ardhurat* për aktivet (detyrimet) për tatime të shtyra dhe shpenzimet (të ardhurat) për tatime (shih paragrafët B9–B12).

25 Nëse njësia ekonomike paraqet një operacion jo të vijueshëm ose një grup të nxjerrë jashtë përdorimit në përputhje me SNRF 5 *Aktive Afatgjata të Mbajtura për Shitje dhe Veprimtaritë e Ndërprera*, ajo duhet të paraqesë çdo tepricë llogarie për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore që i takon si dhe lëvizjen neto në këto teprica, nëse është e zbatueshme, bashkë me tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore dhe lëvizjet në këto teprica dhe jo brenda grupeve të nxjerra jashtë përdorimit ose operacioneve jo të vijueshme.

26 Nëse një njësi ekonomike paraqet fitimet për aksion në përputhje me SNK 33 *Fitimet për Aksion*, ajo duhet të paraqesë edhe fitimet bazë dhe të pakësuara për aksion, të llogaritura sipas shumave të fitimeve të përcaktuara në SNK 33 por duke përjashtuar lëvizjet e tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore (shih paragrafët B13–B14).

Dhënia e informacioneve shpjeguese

Objektivi

27 Njësia ekonomike që zgjedh të zbatojë këtë Standard duhet të japë informacione shpjeguese të cilat u mundësojnë përdoruesve të vlerësojnë:

(a) natyrën dhe risqet e lidhura me rregullimin e normës (tarifës) që përcakton çmimin për klientët për të mirat dhe shërbimet që ofron njësia ekonomike dhe

(b) efektet e këtyre normave rregulluese mbi pozicionin e saj financiar, performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare.

28 Çdo dhënie informacionesh shpjeguese e paraqitur në paragrafët 30–36, e cila nuk konsiderohet e rëndësishme për plotësimin e objektivit në paragrafin 27, mund të hiqet nga pasqyrat financiare. Nëse dhënia e informacioneve shpjeguese sipas kërkesave në paragrafët 30–36 është e pamjaftueshme për të plotësuar objektivin në paragrafin 27, njësia ekonomike duhet të japë informacion shtesë për të plotësuar këtë objektiv.

29 Për të realizuar objektivin në paragrafin 27, një njësi ekonomike merr në konsideratë të gjitha sa më poshtë:

(a) nivelin e detajimit të nevojshëm të hollësive për të përmbushur kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese;

(b) nivelin e rëndësisë që duhet t`u jepet kërkesave të ndryshme;

(c) sa grupime apo ndarje zërash duhen bërë; dhe

(d) nëse përdoruesit e pasqyrave financiare kanë nevojë për informacion shtesë për të vlerësuar informacionin sasior të shpjeguar.

Shpjegimi i aktiviteteve subjekt i rregullimit të normës (tarifës)

30 Për të ndihmuar përdoruesit e pasqyrave financiare që të kuptojnë natyrën dhe risqet e lidhura me aktivitetet me normë (tarifë) të rregullueshme të njësisë ekonomike, kjo e fundit duhet që për çdo tip të aktiviteteve me normë (tarifë) të rregullueshme, të japë informacion shpjegues:

(a) një përshkrim të shkurtër të natyrës dhe madhësisë së aktiviteteve me normë (tarifë) të rregullueshme dhe natyrës së procesit rregullator të vendosjes së normave (tarifave).

(b) identitetin e entitetit rregullator të normës (tarifës). Nëse enti rregullator i normës (tarifës) është një palë e lidhur (sipas përkufizimit në SNK 24 *Dhënie e Informacioneve Shpjeguese mbi Palët e Lidhura*), njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues mbi këtë fakt së bashku me një shpjegim sesi është lidhur;

(c) sesi rreziqet dhe pasiguria ndikojnë mbi rikuperimin e ardhshëm të çdo klase (d.m.th çdo lloji kostoje apo të ardhure) teprice llogarie për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore ose

© IFRS Foundation

anullimin e çdo klase teprice llogarie për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, për shembull:

(i) rreziku lidhur me kërkesën (për shembull ndryshimet në shijet e klientëve, praninë e burimeve të tjera të ofertës ose niveli i konkurrencës);

(ii) rreziku rregullator (për shembull, paraqitja ose miratimi i një aplikimi për vendosje norme ose vlerësimi i njësisë ekonomike mbi ndërhyrjet e ardhshme të pritshme të autoritetit rregullator); dhe

(iii) rreziqet e tjera (për shembull, rreziku i kurseve të këmbimit ose rreziqet e tjera të tregut).

31 Dhënia e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 30 duhet të jepet në pasqyrat financiare ose drejtpërdrejt në shënimet shpjeguese ose të përfshihet nëpërmjet referencës së kryqëzuar me pasqyrat financiare në pasqyra të tjera, të tilla si komentet e menaxhimit ose raporti i rrezikut, që janë të disponueshme për përdoruesit e pasqyrave financiare në të njëjtat terma si pasqyrat financiare dhe në të njëjtën kohë. Pasqyrat financiare nuk janë të plota nëse këto informacione nuk përfshihen në to drejtpërdrejt ose nëpërmjet referencës së kryqëzuar.

Shpjegimi i shumave të njohura

32 Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për bazën e njohjes dhe çregjistrimit të tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore. Gjithashtu ajo duhet të japë informacion shpjegues për matjen fillestare dhe të mëpasshme të tyre, përfshirë mënyrën e vlerësimit për rikuperim dhe shpërndarjen e çdo humbjeje nga zhvlerësimi.

33 Për secilin lloj të aktiviteteve me normë (tarifë) të rregullueshme, njësia ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues në vijim për çdo klasë teprice llogarie për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore:

(a) një rakordim në formë tabele të vlerës kontabël (neto) në fillim dhe në fund të periudhës, me përjashtim të rastit kur një format tjetër është më i përshtatshëm. Njësia ekonomike duhet të përdorë gjykimin për të përcaktuar nivelin e përshtatshëm të hollësive (shih paragrafët 28–29), por përbërësit në vijim janë zakonisht të rëndësishëm:

(i) shumat e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar në periudhën aktuale si teprica llogarish për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore;

(ii) shumat e njohura në pasqyrën (pasqyrat) e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse që lidhen me tepricat e rikuperuara (ndonjëherë përshkruhen si të amortizuara) ose të anuluara në periudhën aktuale; dhe

(iii) shumat e tjera, të identifikuara veçmas, të cilat kanë ndikuar në tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, si zhvlerësimet, zërat e blerë ose të supozuar në një kombinim biznesi, zërat e nxjerrë jashtë përdorimit ose efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit ose normat e skontimit;

(b) normën e kthimit ose të skontimit (përfshirë një normë zero ose një interval normash nëse është e zbatueshme) të përdorur për të reflektuar vlerën në kohë të parasë që është e zbatueshme për çdo klasë teprice llogarie për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore; dhe

(c) periudhat e mbetura gjatë të cilave njësia ekonomike pret të rikuperojë (ose amortizojë) vlerën kontabël (neto) të çdo klase tepricash debitore të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore ose të anulojë çdo klase tepricash kreditore të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore.

34 Nëse rregullimi i normës ndikon shumat dhe kohën e shpenzimeve (të ardhurave) të tatimeve mbi të ardhurat, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues mbi ndikimin e rregullimit të normës në shumat aktuale dhe të shtyra të tatimit të njohur. Gjithashtu njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues të veçantë për çdo tepricë llogarie për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore që lidhet me tatimet dhe lëvizjet përkatëse në atë tepricë.

35 Nëse njësia ekonomike jep informacione shpjeguese sipas SNRF 12 *Dhënia e Informacionit Shpjegues mbi Interesat në Njësitë e Tjera Ekonomike* mbi interesin në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të lidhur që ka aktivitete me normë (tarifë) të rregullueshme dhe tepricat përkatëse të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore njihen në përputhje me këtë Standard, njësia duhet të japë informacion shpjegues edhe për shumat e përfshira në tepricat debitore dhe kreditore të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore dhe lëvizjen neto të këtyre tepricave që lidhen me këto interesa (shih paragrafët B25–B28).

36 Nëse njësia ekonomike arrin në përfundimin se teprica e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore nuk është më plotësisht e rikuperueshme ose e kthyeshme, ajo duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt, arsyet pse nuk është e rikuperueshme ose e kthyeshme dhe shumën me të cilën është pakësuar teprica e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore.

© IFRS Foundation

Shtojca A
Termat e përkufizuara

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Standardit.

pasqyrat e para financiare sipas SNRF-ve	Pasqyrat e para financiare në të cilat një njësi ekonomike përdor për herë të parë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të) nëpërmjet një deklarate të qartë dhe pa rezerva të pajtueshmërisë me SNRF-të.
adoptues për herë të parë	Një njësi ekonomike që paraqet për herë të parë **pasqyrat financiare të saj sipas SNRF-ve**.
PPPK – të e mëparshme	Baza e kontabilitetit të **adoptuesit për herë të parë** e përdorur deri para adoptimit të SNRF-ve.
Aktivitete me normë (tarifë) të rregullueshme	Aktivitete të njësisë ekonomike të cilat janë subjekt i **rregullimit të normës (tarifës)**
Rregullimi i normës (tarifës)	Kuadër që shërben për të përcaktuar çmimet që mund t'u kërkohen klientëve për të mirat ose shërbimet e ofruara dhe që është subjekt i mbikëqyrjes dhe/ose miratimit nga një **rregullator i normës (tarifës)**.
Rregullator i normës (tarifës)	Një autoritet i fuqizuar nga statuti ose ligji për të përcaktuar normën ose një interval normash që një njësi ekonomike duhet të respektojë. **Rregullatori i normës (tarifës)** mund të jetë një autoritet palë e tretë ose një palë e lidhur me njësinë e ekonomike, përfshirë këshillin drejtues të saj, nëse këtij autoriteti i kërkohet nga statuti ose ligji për të vendosur si normat në interes të klientëve ashtu dhe për të garantuar qëndrueshmërinë financiare të njësisë ekonomike.
Tepricë llogarie për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore	Teprica e çdo llogarie shpenzimi (ose të ardhurash) e cila nuk do të njihej si aktiv ose detyrim në përputhje me Standardet e tjera, por që plotëson kriteret e shtyrjes sepse përfshihet ose pritet të përfshihet nga **rregullatori i normës (tarifës)** në përcaktimin e normës (normave) që mund t'i kërkohet klientëve.

Shtojca B
Udhëzim për zbatim

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Standardit.

Aktivitete me normë (tarifë) të rregullueshme

B1 Zakonisht, rregullimi i normës (tarifës) zbatohet për të gjitha aktivitetet e një njësie ekonomike. Megjithatë, sot për shkak të blerjeve, diversifikimeve dhe liberalizime ve, rregullimi i normës (tarifës) mund të zbatohet vetëm për një pjesë të aktiviteteve të njësisë ekonomike. Kjo sjell si pasojë që njësitë ekonomike të kenë njëkohësisht aktivitete të rregulluara dhe të parregulluara. Ky Standard zbatohet vetëm për aktivitetet me normë (tarifë) të rregullueshme që janë subjekt i kufizimeve statutore ose rregullatore përmes veprimeve të një rregullatori të normës (tarifës), pavarësisht nga lloji i njësisë ekonomike ose industrisë së cilës i përket.

B2 Një njësi ekonomike nuk duhet të zbatojë këtë Standard për aktivitete të vetë rregulluara, d.m.th aktivitete që nuk janë subjekt i një kuadri të përcaktimit të çmimeve, i cili mbikëqyret dhe/ose miratohet nga një rregullator i normës (tarifës). Kjo nuk e pengon njësinë ekonomike të zbatojë këtë Standard nëse:

(a) kështilli drejtues i njësisë ekonomike ose një palë e lidhur përcakton normat në interes të klientëve dhe për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të njësisë ekonomike, brenda një kuadri të caktuar të përcaktimit të çmimeve; dhe

(b) ky kuadër është subjekt i mbikëqyrjes dhe/ose miratimit nga një autoritet i fuqizuar nga statuti ose ligji.

Vijimësia e politikave kontabël ekzistuese

B3 Për qëllime të këtij Standardi, teprica e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore përkufizohet si teprica e çdo llogarie shpenzimi (ose të ardhurash) e cila nuk do të njihej si aktiv ose detyrim në përputhje me Standardet e tjera, por që plotëson kriteret e shtyrjes sepse përfshihet ose pritet të përfshihet nga rregullatori i normës (tarifës) në përcaktimin e normës (normave) që mund t'i kërkohet klientëve. Disa zëra të shpenzimeve (të ardhurave) mund të mos merren në konsideratë për normën (normat) e rregulluar sepse, për shembull, shumat nuk pritet të pranohen nga rregullatori i normës ose nuk janë brenda objektit të rregullimit të normës. Për pasojë një zë i tillë njihet si e ardhur ose shpenzim kur ndodh, me përjashtim të rastit kur një Standard tjetër lejon ose kërkon që zëri të përfshihet në vlerën kontabël (neto) të një aktivi ose detyrimi.

B4 Në disa raste, Standardet e tjera ndalojnë qartazi një njësi ekonomike që të njohë në pasqyrën e pozicionit financiar, teprica të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, të cilat mund të njihen veçmas ose të përfshira në zëra të tjerë si aktivet afatgjata materiale në përputhje me politikat kontabël sipas PPPK-ve të mëparshme. Megjithatë, në përputhje me paragrafin 11 të këtij Standardi, një njësi ekonomike që zgjedh të zbatojë këtë Standard për pasqyrat e saj financiare të para sipas SNRF-ve zbaton përjashtimin e paragrafit 11 të SNK 8 me qëllim që të vijojë zbatimin e politikave kontabël sipas PPPK të mëparshme për njohjen, matjen, zhvlerësimin dhe mosnjohjen e tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore. Politika të tilla kontabël mund të përfshijnë praktikat në vijim, për shembull:

(a) njohjen e një teprice debitore të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore kur njësia ekonomike ka një të drejtë, si rezultat i ndërhyrjeve aktuale ose të ardhshme të rregullatorit të normës, të rrisë normat në periudhat e ardhshme me qëllim mbulimin e kostove të lejuara (d.m.th kostot për të cilat norma e rregulluar synon të ofrojë mbulim).

(b) njohjen si tepricë debitore ose kreditore të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, të një shume ekuivalente me çdo humbje ose fitim nga nxjerrja prej përdorimit ose tërheqja e të dy zërave: të aktivit afatgjatë material dhe të aktivit jomaterial, që pritet të rikuperohet ose anullohet nga normat e ardhshme;

(c) njohjen e një teprice kreditore të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore kur kërkohet që njësia ekonomike, si pasojë e ndërhyrjeve aktuale ose të ardhshme të rregullatorit të normës, të ulë normat në periudhat e ardhshme me qëllim anullimin e tejkalimit të mbulimit të kostove të lejuara (d.m.th tepricën e shumave të rikuperueshme të specifikuar nga rregullatori i normës); dhe

© IFRS Foundation

(d) matjen e tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore mbi baza jo të aktualizuara ose mbi një bazë të aktualizuar që përdor një normë interesi ose skontimi të specifikuar nga rregullatori i normës.

B5 Në vijim jepen shembuj të llojeve të kostove që rregullatorët e normës mund të autorizojnë në vendimmarrjen e tyre për vendosjen e normave dhe që një njësi ekonomike, si rrjedhim, mund t'i njohë në tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore:

(i) ndryshimet në vëllim ose çmimin e blerjes;

(ii) kostot e miratuara lidhur me iniciativat 'energji e gjelbër' (d.m.th tepricat e shumave të kapitalizuara si pjesë e kostos së aktiveve afatgjata materiale në përputhje me SNK 16 *Aktivet Afatgjata Materiale*);

(iii) kostot e tjera jo të ngarkueshme drejtpërdrejtë të cilat trajtohen si kosto kapitale për qëllime të rregullimit të normës (por që sipas SNK 16 nuk lejohet të përfshihen në koston e një zëri të aktiveve afatgjata materiale);

(iv) kosto të anullimit të projektit;

(v) kosto të dëmit nga koha e keqe; dhe

(vi) interesi i supozuar (përfshirë shumat e lejuara për fonde të krijuara gjatë ndërtimit të cilat i sigurojnë njësisë ekonomike një kthim në kapitalin neto të pronarit si dhe huadhëniet).

B6 Zakonisht, tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore përfaqësojnë diferenca kohore mes njohjes së zërave të të ardhurave ose shpenzimeve për qëllime rregullatore dhe njohjes së këtyre zërave për qëllime të raportimit financiar. Nëse njësia ekonomike ndryshon një politikë kontabël në pasqyrat e saj financiare të para sipas SNRF-ve ose gjatë zbatimit fillestar të një Standardi të ri ose të rishikuar, mund të lindin diferenca kohore të reja ose të rishikuara të cilat krijojnë teprica të reja ose të rishikuara të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore. Ndalesa në paragrafin 13 e cila pengon një njësi ekonomike të ndryshojë politikën e saj kontabël me qëllim që të fillojë njohjen e tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, nuk ndalon njohjen e tepricave të reja ose të rishikuara të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, të krijuara për shkak të ndryshimeve të tjera në politikat kontabël të kërkuara nga SNRF-të. Kjo sepse njohja e tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore për diferenca kohore të tilla është në pajtim me politikat ekzistuese për njohjen të zbatuara në përputhje me paragrafin 11 dhe nuk përbën politikë të re kontabël. Po ashtu, paragrafi 13 nuk ndalon njohjen e tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, të cilat vijnë nga diferenca kohore që nuk ekzistonin në datën menjëherë para kalimit në SNRF por që janë në pajtim me politikat kontabël të njësisë ekonomike të përcaktuara në përputhje me paragrafin 11 (për shembull, kostot e dëmit nga moti i keq).

Zbatimi i Standardeve të tjera

B7 Një njësi ekonomike që është brenda objektit të këtij Standardi dhe zgjedh ta zbatojë atë duhet të vijojë zbatimin e politikave kontabël të saj sipas PPPK të mëparshme për njohjen, matjen, zhvlerësimin dhe mosnjohjen e tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore. Por paragrafët 16–17 specifikojnë se në disa raste mund të jetë e nevojshme të zbatohen edhe Standarde të tjera me qëllim që tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore të pasqyrohen në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare. Paragrafët në vijim tregojnë sesi Standardet e tjera ndërveprojnë me kërkesat e këtij Standardi. Në mënyrë të veçantë paragrafët në vijim sqarojnë përjashtime specifike për dhe nga Standardet e tjera dhe kërkesa shtesë për paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese që pritet të jenë të zbatueshme.

Zbatimi i SNK 10 *Ngjarje pas Periudhës së Raportimit*

B8 Mund të jetë e nevojshme që njësia ekonomike të përdorë vlerësime dhe supozime për njohjen dhe matjen e tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore. Për ngjarjet që ndodhin pas fundit të periudhës raportuese dhe para datës kur pasqyrat financiare autorizohen për publikim, njësia ekonomike duhet të zbatojë SNK 10 për të identifikuar nëse këto vlerësime dhe supozime duhet të korrigjohen për të reflektuar këto ngjarje.

Zbatimi i SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat*

B9 SNK 12 kërkon, me pak përjashtime, që një njësi ekonomike të njohë një detyrim për tatime të shtyra dhe (me plotësimin e disa kushteve) një aktiv për tatime të shtyra për të gjitha diferencat kohore. Një njësi ekonomike subjekt i rregullimit të normës duhet të zbatojë SNK 12 për të gjitha aktivitetet e saj, përfshirë aktivitetet me normë (tarifë) të rregullueshme, për të identifikuar shumën e tatimit mbi të ardhurat që duhet të njihet.

B10 Në disa skema të rregullimit të normës (tarifës), rregullatori i normës (tarifës) lejon ose i kërkon njësisë ekonomike të rrisë normat e saj të ardhshme me qëllim mbulimin e një pjese ose të të gjithë shpenzimit për tatimin mbi të ardhurat të njësisë ekonomike. Në rrethana të tilla, është e mundur që në përputhje me politikat kontabël të përcaktuara sipas paragrafëve 11–12, njësia ekonomike të njohë në pasqyrën e pozicionit financiar një tepricë llogarie për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore lidhur me tatimin mbi të ardhurat. Njohja e kësaj teprice llogarie për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore të lidhur me tatimin mbi të ardhurat mund të krijojë një diferencë kohore shtesë për të cilën duhet të njihet një shumë tjetër e tatimit të shtyrë.

B11 Pavarësisht kërkesave për paraqitje dhe dhënie informacionesh shpjeguese të SNK 12, nëse njësia ekonomike njeh një aktiv ose detyrim për tatime të shtyra si pasojë e njohjes së tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, ajo nuk duhet të përfshijë shumën e tatimit të shtyrë në totalin e tepricave të aktivit (detyrimit) për tatimin e shtyrë. Por njësia ekonomike duhet të paraqesë aktivin (detyrimin) për tatime të shtyra që vjen si pasojë e njohjes së tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore ose:

(a) bashkë me zërat e paraqitur për tepricat debitore dhe kreditore të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore; ose

(b) si zë i veçantë, pranë tepricave përkatëse debitore dhe kreditore të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore.

B12 Në mënyrë të ngjashme, nëse një njësi ekonomike njeh lëvizjen e një aktivi (detyrimi) për tatime të shtyra që vjen nga njohja e tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, ajo nuk duhet të përfshijë këtë lëvizje në zërin e shpenzimeve (të ardhurave) për tatimet të paraqitur në pasqyrën (pasqyrat) e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera përmbledhëse në përputhje me SNK 12. Por njësia ekonomike duhet ta paraqesë lëvizjen në aktivin (detyrimin) për tatime të shtyra që vjen si pasojë e njohjes së tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore ose:

(a) bashkë me zërat e paraqitur në pasqyrën (pasqyrat) e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse për lëvizjet në tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore; ose

(b) si zë i veçantë pranë zërave përkatës të paraqitur në pasqyrën (pasqyrat) e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse për lëvizjet në tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore.

Zbatimi i SNK 33 *Fitimet për Aksion*

B13 Paragrafi 66 i SNK 33 detyron disa njësi ekonomike që të paraqesin, në pasqyrën e fitimit apo humbjes dhe të të ardhurave të tjera përmbledhëse, fitimet bazë dhe të pakësuara për aksion si për fitimin ose humbjen nga operacionet e vazhdueshme ashtu dhe për fitimin ose humbjen që u takon zotëruesve të kapitalit të shoqërisë mëmë. Gjithashtu paragrafi 68 i SNK 33 i kërkon një njësie ekonomike që raporton një operacion jo të vazhdueshëm të japë informacione shpjeguese për shumat bazë dhe të pakësuara për aksion për operacionin jo të vazhdueshëm ose në pasqyrën e fitimit apo humbjes dhe të të ardhurave të tjera përmbledhëse ose në shënimet shpjeguese.

B14 Për çdo shumë të fitimit për aksion të paraqitur në përputhje me SNK 33, një njësi ekonomike që zbaton këtë Standard duhet të paraqesë shumat shtesë të fitimeve bazë dhe të pakësuara për aksion të llogaritura në të njëjtën mënyrë, me përjashtimin që shumat të mos përfshijnë lëvizjen neto të tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore. Në përputhje me kërkesat në paragrafin 73 të SNK 33 njësia ekonomike duhet të paraqesë fitimet për aksion të kërkuara nga paragrafi 26 i këtij Standardi me rëndësi të barabartë me fitimet për aksion të kërkuara nga SNK 33, për të gjitha periudhat e paraqitura.

© IFRS Foundation

Zbatimi i SNK i 36 *Zhvlerësimi i Aktiveve*

B15 Paragrafët 11–12, kërkojnë që njësia ekonomike të vijojë zbatimin e politikave të saj kontabël sipas PPPK-ve të mëparshme për identifikimin, njohjen, matjen dhe anullimin e çdo zhvlerësimi të njohur në tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore. Prandaj SNK 36 nuk zbatohet për teprica të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore tashmë të njohura.

B16 Por sipas SNK 36 një njësie ekonomike mund t'i duhet të kryejë një test çvlerësimi për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare (NJGJMM) që përfshin tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore. Ky test mund të kërkohet sepse NJGJMM përfshin emrin e mirë ose sepse një ose më shumë tregues të rënies në vlerë të përshkruar në SNK 36, identifikohen si të lidhur me NJGJMM. Në raste të tilla, kërkesat për identifikimin e shumës së rikuperueshme dhe vlerës kontabël (neto) të një NJGJMM jepen në paragrafët 74–79 të SNK 36. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto kërkesa për të përcaktuar nëse ndonjë tepricë e njohur e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore është përfshirë në vlerën kontabël (neto) të NJGJMM për qëllime të testimit për zhvlerësim. Kërkesat e mbetura të SNK 36 duhet të zbatohen për ndonjë humbje nga çvlerësimi të njohur si rezultat i këtij testi.

Zbatimi i SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit*

B17 Parimi bazë i SNRF 3 është që një blerës i një biznesi njeh aktivet e blera dhe detyrimet e supozuara me vlerën e drejtë të tyre në ditën e blerjes. SNRF 3 parashikon përjashtime të kufizuara për parimin e njohjes dhe të matjes. Paragrafi B18 i këtij Standardi parashikon një përjashtim shtesë.

B18 Paragrafët 11–12, kërkojnë që njësia ekonomike të vijojë zbatimin e politikave të saj kontabël sipas PPPK-ve të mëparshme për njohjen, matjen, zhvlerësimin dhe çregjistrimin e tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore. Prandaj nëse një njësi ekonomike blen një biznes, ajo duhet të zbatojë në pasqyrat e saj financiare të konsoliduara politikat kontabël të përcaktuara në përputhje me paragrafët 11–12 për njohjen dhe matjen e tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore të biznesit të blerë në datën e blerjes. Tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore të biznesit të blerë duhet të njihen në pasqyrat financiare të konsoliduara të blerësit në përputhje me politikat kontabël të tij, pavarësisht nëse biznesi i blerë i ka njohur ose jo në pasqyrat e veta financiare këto teprica.

Zbatimi i SNRF 5 *Aktive Afatgjata të Mbajtura për Shitje dhe Veprimtaritë e Ndërprera*

B19 Paragrafët 11–12, kërkojnë që njësia ekonomike të vijojë zbatimin e politikave të saj kontabël të mëparshme për njohjen, matjen, zhvlerësimin dhe çregjistrimin e tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore. Prandaj kërkesat për matjen të SNRF 5 nuk duhet të zbatohen për tepricat e njohura të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore.

B20 Paragrafi 33 i SNRF 5 kërkon paraqitjen e një shume të vetme për operacionet jo të vijueshme në pasqyrën (pasqyrat) e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera përmbledhëse. Pavarësisht kërkesave të këtij paragrafi, nëse njësia ekonomike zgjedh të zbatojë këtë Standard dhe paraqet një operacion jo të vijueshëm, ajo nuk duhet të përfshijë lëvizjen në tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, që vjen nga aktivitete me normë (tarifë) të rregullueshme të operacionit jo të vijueshëm, në zërat që kërkohen nga paragrafi 33 i SNRF 5. Por njësia ekonomike duhet ta paraqesë lëvizjen në tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, që vjen nga aktivitete me normë (tarifë) të rregullueshme të operacionit jo të vijueshëm ose:

(a) bashkë me zërin e paraqitur për lëvizjet në tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, të lidhura me fitimin ose humbjen; ose

(b) si zë i veçantë pranë zërit përkatës të paraqitur për lëvizjet në tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore të lidhura me fitimin ose humbjen.

B21 Në mënyrë të ngjashme, pavarësisht kërkesave të paragrafit 38 të SNRF 8, nëse një njësi ekonomike paraqet një grup të nxjerrë jashtë përdorimit, ajo nuk duhet të përfshijë totalin e tepricave debitore dhe kreditore të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore që janë pjesë e një grupi të nxjerrë jashtë përdorimit bashkë me zërat e kërkuar nga paragrafi 38 i SNRF 5. Njësia ekonomike duhet të paraqesë totalin e tepricave debitore dhe kreditore të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore që janë pjesë e një grupi të nxjerrë jashtë përdorimit ose:

(a) bashkë me zërat e paraqitur për tepricat debitore dhe kreditore të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore; ose

(b) si zë të veçantë, pranë tepricave përkatëse debitore dhe kreditore të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore.

B22 Nëse njësia ekonomike zgjedh të përfshijë tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore dhe lëvizjet në këto teprica, të lidhura me një grup të nxjerrë jashtë përdorimit ose me një operacion jo të vijueshëm, bashkë me zërin përkatës të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, mund të jetë e nevojshme dhënia e informacioneve shpjeguese të veçanta si pjesë e analizës të përshkruar në paragrafin 33 të këtij Standardi për zërat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore.

Zbatimi i SNRF 10 *Pasqyra Financiare të Konsoliduara* dhe SNK 28 *Investimet në Pjesëmarrjet dhe në Sipërmarrjet e Përbashkëta*

B23 Sipas paragrafit 19 të SNRF 10 "një shoqëri mëmë duhet të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara duke përdorur politika kontabël uniforme si për transaksionet, ashtu dhe ngjarjet e tjera në rrethana të ngjashme". Sipas paragrafit 8 të këtij Standardi, nëse një njësi ekonomike është brenda objektit të këtij Standardi dhe zgjedh ta zbatojë atë, duhet të zbatojë edhe të gjitha kërkesat e Standardit për të gjitha tepricat e llogarive të shtyra për arsye rregulatore që vijnë nga të gjitha aktivitetet me normë (tarifë) të rregullueshme të saj. Për pasojë, nëse një shoqëri mëmë njeh në pasqyrat e saj financiare të konsoliduara teprica të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore në përputhje me këtë Standard, ajo duhet të zbatojë të njëjtat politika kontabël për tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore në të gjitha filialet e saj. Kjo kërkesë zbatohet pavarësisht nëse filialet i njohin ose jo këto teprica në pasqyrat financiare të tyre.

B24 Në mënyrë të ngjashme, sipas paragrafëve 35–36 të SNK 28 kërkohet që gjatë zbatimit të metodës së kapitalit neto "pasqyrat financiare të njësisë ekonomike duhet të përgatiten duke përdorur politika kontabël uniforme si për transaksionet, ashtu dhe ngjarjet e tjera në rrethana të ngjashme". Prandaj, duhen bërë rregullime që politikat kontabël të pjesëmarrjeve ose sipërmarrjeve të përbashkëta për njohjen, matjen, zhvlerësimin dhe çregjistrimin e tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, të jenë në pajtim me ato të njësisë ekonomike investuese me qëllim zbatimin e metodës së kapitalit neto.

Zbatimi i SNRF 12 *Dhënia e Informacionit Shpjegues mbi Interesat në Njësitë e Tjera Ekonomike*

B25 Paragrafi 12(e) i SNRF 12, detyron një njësi ekonomike që për çdo filial në të cilin mban interesa jo kontrolluese të rëndësishme për të, të japë informacione shpjeguese mbi fitimin ose humbjen që i takon interesave jo kontrolluese të filialit gjatë periudhës së raportimit. Njësia ekonomike që njeh tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore në përputhje me këtë Standard duhet të japë informacion shpjegues mbi lëvizjen neto në tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, të përfshirë në shumat për të cilat duhet të japë informacione shpjeguese sipas paragrafit 12(e) të SNRF 12.

B26 Paragrafi 12(g) i SNRF 12, detyron një njësi ekonomike që për çdo filial në të cilin mban interesa jo kontrolluese të rëndësishme për të, të japë informacione shpjeguese financiare të përmbledhura mbi filialin, të specifikuara në paragrafin B10 të SNRF 12. Në mënyrë të ngjashme, paragrafi 21(b) i SNRF 12, detyron një njësi ekonomike që për çdo sipërmarrje të përbashkët dhe pjesëmarrje të rëndësishme për të, të japë informacione shpjeguese financiare të përmbledhura, të specifikuara në paragrafët B12–B13 të SNRF 12. Paragrafi B16 i SNRF 12 specifikon informacionin financiar përmbledhës që duhet të japë një njësi ekonomike lidhur me të gjitha pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta të tjera, të cilat nuk janë të rëndësishme të marra një e nga një, sipas paragrafit 21(c) të SNRF 12.

B27 Përvec informacionit të specifikuar në paragrafët 12, 21, B10, B12–B13 dhe B16 të SNRF 12, një njësi ekonomike e cila njeh tepricat e llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore në përputhje me këtë Standard, duhet të japë informacione shpjeguese edhe për tepricat debitore dhe kreditore të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore dhe lëvizjen neto në këto teprica, duke ndarë shumat e njohura në fitim ose humbje nga shumat e njohura në të ardhurat e tjera përmbledhëse, për secilën njësi ekonomike për të cilën kërkohet dhënia e informacionit shpjegues sipas SNRF 12.

B28 Paragrafi 19 i SNRF 12 specifikon informacionet shpjeguese që duhet të japë një njësi ekonomike kur njeh një fitim ose humbje të llogaritur sipas kërkesave të paragrafit 25 të SNRF 10 për shkak të humbjes së kontrollit në një filial. Përvec informacionit të kërkuar nga paragrafi 19 i SNRF 12, njësia ekonomike që

 © IFRS Foundation

zgjedh të zbatojë këtë Standard duhet të japë informacione shpjeguese edhe për pjesën e fitimit ose humbjes që i takon çregjistrimit të tepricave të llogarive për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore, në ish-filialin në datën e humbjes së kontrollit.

Shtojca C
Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Standardit.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Data e hyrjes në fuqi

C1 Njësia ekonomike duhet ta zbatojë këtë SNRF nëse pasqyrat financiare të saj, të parat sipas SNRF-ve, janë për një periudhë që fillon më datën 1 Janar 2016 e në vijim. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

© IFRS Foundation